



Këshilli i Lartë i Drejtësisë

VENDIM

Nr. 261/2, datë 14.04.2010

SISTEMI I VLERËSIMIT TË GJYQTARËVE

Në mbështetje të Ligjit Nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, nenet 1, 2, pika “dh” dhe 16, paragrafi 1, pika “dh”; të Ligjit Nr.9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 13 e 44, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si autoriteti përgjegjës që bën vlerësimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit,

V E N D O S I:

Të miratojë Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve, si më poshtë:
Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në vlerësimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, i përmbahet respektimit të parimit të pavarësisë së gjyqtarëve.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi i Sistemit

Ky Sistem ka për qëllim:

- a. Të evidentojë vlerat profesionale të gjyqtarëve për efekt të karrierës së tyre;
- b. Të identifikojë gjyqtarët që rezultojnë me pamjaftueshmëri profesionale dhe gjyqtarët me cilësi më të lartë;
- c. Të konstatojë problematikat që ndeshen në gjykata gjatë verifikimit të veprimtarisë së tyre profesionale;
- d. Të identifikojë nevojat për trajnim vazhdues të gjyqtarëve, në shërbim të rritjes së profesionalizmit të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, si dhe të kryetarëve të këtyre gjykatave, bazuar dhe realizuar në kriteret dhe procedurat e parashikuara në të.

Neni 2

Mënyra dhe forma e vlerësimit

1. Vlerësimi i punës së gjyqtarit do të kryhet duke vlerësuar të gjithë elementët e procesit të tij të punës.
2. Ky vlerësim do të përgatitet në formë përshkruese dhe statistikore nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe do të bëhet nga vetë Këshilli.
3. Sistemi i Vlerësimit përfshin tre faza:
 - a. Vlerësimi i kryetarit të gjykatës i ndjekur nga vetëvlerësimi i gjyqtarit, (ky i fundit akt jo i domosdoshëm që përdoret vetëm në ato raste kur gjyqtari çmon të plotësojë formularin e vetëvlerësimit);
 - b. Raporti konstatues dhe Projektakti i vlerësimit nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
 - c. Akti i vlerësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
4. Procesi i vlerësimit do të mbështetet në të dhënat dhe procedurat e përcaktuara nga ky sistem, duke iu referuar kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore të parashikuara në aneksin 1 të tij.
5. Për mundësimin e vlerësimit, pranë çdo gjykate, kancelari ngarkon dhe mbikëqyr një ose disa punonjës të administratës/sekretarisë gjyqësore, që janë përgjegjës për përpilimin dhe garantimin e vërtetësisë të të dhënave të paraqitura në tabelën statistikore. Në këto tabela duhet të jenë të fiksuara për çdo gjyqtar:
 - numri i çështjeve të gjykuara prej tij si relator/kryesues, numri i çështjeve ku ai ka marrë pjesë si anëtar i trupit gjykues (duke u përfshirë dhe numri i çështjeve ku gjyqtari ka qenë relator apo anëtar i deleguar në gjykatat e të njëjtit nivel), gjatë një viti kalendarik;
 - numri i çështjeve të ankimuara në gjykatat më të larta, numri i çështjeve të cenuara prej tyre dhe i atyre të lëna në fuqi;
 - numri i çështjeve të gjykuara tej afateve standarde të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Në tabelën statistikore duhet të jenë llogaritur në përqindje: numri i çështjeve të cenuara nga gjykatat më të larta (duke specifikuar çështjet e prishura dhe ato me vendime të ndryshuara) në raport me numrin e çështjeve të ankimuara, si edhe numri i çështjeve të gjykuara tej afatit standard e krahasuar me numrin e çështjeve që ka gjykuar gjyqtari si relator/kryesues.

6. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në muajin Nëntor të çdo viti, përcakton gjykatat, gjyqtarët e të cilave do të vlerësohen në vitin pasardhës dhe periudhën e vlerësimit.

KREU II

KRITERET E VLERËSIMIT

Neni 3

Grupet e kritereve të vlerësimit

Vlerësimi profesional dhe etik i gjyqtarëve do të kryhet sipas kritereve të grupuara si më poshtë:

- a. Grupi i aftësive profesionale të përgjithshme, organizuese dhe zbatuese.
- b. Grupi i aftësive profesionale juridike dhe teknike.
- c. Grupi i kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional

Seksioni I

Grupi i aftësive profesionale të përgjithshme, organizuese dhe zbatuese

Neni 4

Aftësitë profesionale të përgjithshme, organizuese dhe zbatuese

Në grupin e aftësive profesionale të përgjithshme, organizuese dhe zbatuese do të përfshihen si më poshtë:

- a. Efektiviteti dhe produktiviteti;
- b. Metodologjia;
- c. Shpejtësia;
- d. Planifikimi i seancave.

Neni 5

Efektiviteti dhe produktiviteti

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të qenë efektiv në zgjidhjen e çështjeve që i janë caktuar për gjykim në aspektin cilësor dhe sasior, në raport me kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe për të qenë produktiv në arsyetimin e dorëzimit të vendimeve brenda afateve ligjore.

Neni 6

Metodologjia

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të planifikuar veprime specifike që lidhen me çështjen sipas një metodologjie të qartë, si dhe për të organizuar veprimet e nevojshme procedurale apo administrative brenda ose jashtë gjykatës ku gjyqtari ushtron funksionin.

Neni 7

Shpejtësia

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të zgjidhur në afate kohore të arsyeshme çështjet që i janë caktuar për gjykim.

Neni 8

Planifikimi i seancave

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të planifikuar drejt e në kohë seancat gjyqësore, me qëllim për të qenë efektiv në përfundimin në kohë të çështjeve gjyqësore.

Seksioni II
Grupi i aftësive profesionale juridike dhe teknike

Neni 9
Aftësitë profesionale juridike dhe teknike.

Në grupin e kriterëve të aftësive profesionale juridike dhe teknike të gjyqtarit, që do të vlerësojë aspektet e mësipërme të procesit të punës së gjyqtarit, do të përfshihen:

- a. Qartësia e të shkruarit të vendimit;
- b. Aftësia në drejtimin e procesit gjyqësor;
- c. Aftësia për të krijuar dhe administruar një dosje gjyqësore.

Neni 10
Qartësia e të shkruarit të vendimit

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të shkruar thjesht dhe qartë një vendim gjyqësor, i cili duhet të jetë i kuptueshëm nga të gjithë.

Neni 11
Aftësia në drejtimin e procesit gjyqësor

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të drejtuar një proces të rregullt gjyqësor, për të drejtuar dhe orientuar drejt debatin gjyqësor, duke u shprehur qartë, në përputhje me rregullat që parashikon ligji dhe etika gjyqësore.

Neni 12
Aftësia për të krijuar dhe administruar një dosje

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të krijuar një dosje gjyqësore, duke strukturuar qartë aktet përbërëse të saj, që të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme.

Seksioni III
Grupi i kriterëve të vlerësimit të kapacitetit njerëzor dhe angazhimi profesional

Neni 13

Në grupin e kapacitetit njerëzor dhe angazhimit profesional të gjyqtarit përfshihen:

- a. Etika e gjyqtarit gjatë dhe jashtë procesit gjyqësor;
- b. Respektimi i solemnitetit dhe disiplinës në punë;
- c. Pjesëmarrja dhe aktivizimi në aktivitete profesionale;
- d. Shkrimet dhe botimet e ndryshme me natyrë juridike.

Neni 14
Etika e gjyqtarit gjatë dhe jashtë procesit

Me këtë kriter vlerësohen aftësitë komunikuese të gjyqtarit gjatë seancave gjyqësore, si dhe mënyra e sjelljes së tij.

Neni 15
Respektimi i solemnitetit dhe disiplinës

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të zhvilluar një proces gjyqësor solemn, në përputhje me ligjin e aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij si edhe për të respektuar disiplinën në punë.

Neni 16
Aftësia në pjesëmarrjen dhe aktivizimin në aktivitetet profesionale dhe trajnuese

Me këtë kriter vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të marrë pjesë aktive në aktivitetet profesionale dhe trajnuese që kryhen brenda dhe jashtë gjykatës, duke identifikuar drejt problematikën e nevojshme dhe duke e trajtuar atë në mënyrë të efektshme.

Neni 17
Shkrimet dhe botimet e ndryshme me natyrë juridike

Me këtë kriter vlerësohet angazhimi i gjyqtarit në thellimin e studimeve juridike duke dhënë kontributin e tij në këtë drejtim.

Seksioni IV
Vlerësimi i Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit

Neni 18

Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit, do të vlerësohen për veprimtarinë e tyre gjyqësore në përputhje me grupet e kritereve të radhitura më sipër.

KREU III
BURIMET, AKTET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Neni 19
Vlerësimi nga Kryetari i gjykatës

1. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit, ku ushtron funksionin gjyqtari, bën vlerësimin e gjyqtarit në formën e një akti të shkruar, sipas formularit, pjesë përbërëse e këtij Sistemi.
2. Në këtë formular, kryetari përshkruan veprimtarinë e gjyqtarit, duke bërë një vlerësim në lidhje me respektimin prej tij të disiplinës në punë, të solemnitetit në gjykim dhe të etikës.

3. Ky vlerësim i kryetarit të gjykatës shoqërohet me tabelat statistikore për volum, cilësi dhe shpejtësi, që janë pjesë përbërëse e këtij Sistemi, me vendimet e gjyqtarit të cenuara nga gjykatat më të larta, si edhe kur është rasti, me aktet që provojnë të dhënat e prezantuara në përshkrimin e veprimtarisë së gjyqtarit.
4. Plotësimi i tabelave statistikore për gjyqtarin, dokumentimi i vendimeve të gjyqtarit të cenuara nga gjykatat më të larta dhe vlerësimi i gjyqtarit nga kryetari i gjykatës bëhet jo më tej se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga momenti i njoftimit për fillimin e procedurës së vlerësimit.
5. Vlerësimi i kryetarit të gjykatës, tabelat statistikore dhe vendimet e cenuara, i bëhen të njohura gjyqtarit brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i tyre nëpërmjet nënshkrimit nga ata të aktit të njoftimit.

Neni 20

Vetëvlerësimi i gjyqtarit

1. Pasi të njihet me vlerësimin e kryetarit dhe aktet që e shoqërojnë atë sipas nenit 19, paragrafi 3, gjyqtari ka të drejtë të kryejë një vlerësim profesional dhe etik të punës së tij nëpërmjet një akti të shkruar, sipas formularit, pjesë përbërëse e këtij Sistemi, me anë të së cilit të përshkruajë veprimtarinë e tij, të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të saj dhe të shprehet mbi secilën aftësi. Plotësimi i formularit të vetëvlerësimit nuk është i detyrueshëm.
2. Të drejtën për vetëvlerësim e kanë edhe kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve.
3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit kryhet brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i njohjes me tabelat statistikore, me vendimet e cenuara nga gjykatat më të larta dhe me vlerësimin e kryetarit të gjykatës, duke u depozituar pranë këtij të fundit.
4. Vetëvlerësimi i kryetarit të gjykatës së shkallës së parë apo i kryetarit të gjykatës së apelit kryhet brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti i njohjes me tabelat statistikore e me vendimet e cenuara nga gjykatat më të larta.
5. Në çdo rast, vetëvlerësimi i gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, i gjyqtarit të gjykatës së apelit, i kryetarit të gjykatës së shkallës së parë ose i kryetarit të gjykatës së apelit, duhet të shoqërohet me vendimet e përzgjedhura nga vetë ata në përputhje me përcaktimin e bërë në nenin 23, pika 1, germa “b”, të këtij Sistemi, si dhe kur është rasti, me aktet që provojnë të dhënat e prezantuara në përshkrimin e veprimtarisë së tij.

Neni 21

Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe angazhimeve profesionale të kryetarëve të gjykatave

Për kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe angazhimeve profesionale siç përshkruhet në nenin 18, bëhet nga Inspektorati pasi janë depozituar aty aktet e vlerësimit sipas nenit 22.

Neni 22
Dërgimi i materialeve të vlerësimit në Inspektorat

Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit kujdeset që, brenda 2 (dy) ditëve nga depozitimi i vetëvlerësimit të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë ose të apelit, të dërgojë pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë materialet e vlerësimit të çdo gjyqtari të gjykatës së apelit ose të gjykatës së shkallës së parë, akte këto të përcaktuara në nenet 19 e 20 të Sistemit.

Neni 23
Vendimet gjyqësore dhe të dhënat e tjera rreth veprimtarisë gjyqësore

1. Për vlerësimin e gjyqtarit do të përdoren:
 - a. Të dhënat që dalin nga dosjet gjyqësore që u përkasin 7 vendimeve të gjyqtarit për çdo vit të vlerësimit, të përzgjedhura me short nga Inspektorati. Për gjyqtarët që nuk janë të caktuar në dhoma gjykimi, do të përzgjidhen me short 4 konflikte civile dhe 3 çështje penale.
 - b. 5 vendime të prezantuara nga vetë gjyqtari për secilin vit që ai vlerësohet;
 - c. Vendimet e gjyqtarit, të cenuara nga gjykatat më të larta. Kur vlerësohet nga inspektori i ngarkuar me verifikimin, për vendimet e prishura, mund të verifikohet i gjithë fashikulli i gjykimit në mënyrë që të evidentohen shkaqet e prishjes.
 - ç. Të dhënat që dalin nga dosjet gjyqësore që u përkasin 20 % të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari tej afateve kohore të përcaktuara në dispozitat pjesë përbërëse të këtij Sistemi, të përzgjedhura me short;
 - d. Të dhënat e rezultuara nga verifikimi i ankesave;
 - dh. Të dhënat e rezultuara nga inspektimi i gjyqtarit apo gjykatës;
 - e. Vlerësimi i kryetarit të gjykatës;
 - ë. Vetëvlerësimi i gjyqtarit (nëse ai vendos të plotësojë formularin përkatës).
2. Të dhënat që dalin nga vëzhgimi i dosjeve gjyqësore, sipas përcaktimeve të bëra në pikën “1” të kësaj dispozite, dokumentohen nga inspektori i ngarkuar në një raport konstatues.

Neni 24
Rregullat e shortit dhe dokumentimi i tij

1. Dosjet gjyqësore që do t'i nënshtrohen vëzhgimit nga inspektori i ngarkuar sipas pikës 1, germa “a”, të nenit 23, të këtij Sistemi, identifikohen me anë të përzgjedhjes së rastësishme ndërmjet vendimeve të gjyqtarit të dhëna brenda periudhës së vlerësimit.
2. Përzgjedhjes me short i nënshtrohen si vendimet e dhëna nga gjyqtari në gjykatën ku ushtron funksionet në mënyrë të përhershme, ashtu dhe ato të dhëna nga ai në gjykatat ku është deleguar për gjykimin e çështjeve konkrete.
3. Shorti sipas kësaj dispozite kryhet pas fillimit të procedurës së vlerësimit të gjyqtarit dhe pavarësisht veprimeve të tjera pjesë përbërëse e këtij procesi.

4. Kryerja e shortit urdhërohet dhe mbikëqyret nga inspektori i ngarkuar, duke pasur në konsideratë përcaktimin e bërë në pikën “1”, germat “a” dhe “ç”, të nenit 23, të këtij Sistemi.
5. Inspektori i ngarkuar paraprakisht identifikon dhomën dhe seksionin ku gjyqtari ka ushtruar funksionin për periudhën e vlerësimit dhe, më pas, në varësi edhe të numrit të vendimeve të dhëna për çdo kategori çështjesh, përcakton numrin e vendimeve që do të përzgjidhen nga secila prej tyre.
6. Shorti realizohet në gjykatën ku ushtron funksionet gjyqtari dhe kryhet nga administrata gjyqësore e gjykatës.
7. Shorti kryhet në prani të gjyqtarit kur ai e çmon të marrë pjesë.
8. Në short përfshihen të gjitha ato vendime të gjyqtarit ku ai ka qenë kryesues apo relator, përveç vendimeve në të cilat ai ka qenë në pakicë.
9. Numri i vendimeve të gjyqtarit të përzgjedhura me anë të shortit për çështjet civile pa palë kundërshtare, për çështjet administrativo-penale dhe për çështjet civile të paregjistruara nuk duhet të kalojë 20% të numrit total të vendimeve të përzgjedhura. Vendimet e kësaj kategorie të përzgjedhura pas plotësimit të kësaj kuote nuk konsiderohen dhe shorti vazhdon për përzgjedhjen e vendimeve të kategorive të tjera.
10. Numri i vendimeve të gjyqtarit të përzgjedhura me anë të shortit që kanë disponuar për pushimin e gjyqimit të çështjeve civile dhe për mospranimin e ankimit nuk duhet të kalojë 10 % të numrit total të vendimeve të përzgjedhura. Vendimet e kësaj kategorie të përzgjedhura pas plotësimit të kësaj kuote nuk konsiderohen dhe shorti vazhdon për përzgjedhjen e vendimeve të kategorive të tjera.
11. Shorti sipas kësaj dispozite dokumentohet në procesverbalin që nënshkruhet nga të gjithë të pranishmit.

Neni 25

Dokumentimi nga Shkolla e Magjistraturës

1. Shkolla e Magjistraturës, si organi i vetëm përgjegjës për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve, për efekt të këtij Sistemi, kryen dokumentimin dhe informimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pjesëmarrjen e gjyqtarit në aktivitetet profesionale dhe trajnuese.
2. Marrja e informacionit nga Shkolla e Magjistraturës kryhet nga inspektori i ngarkuar pas fillimit të procedurës së vlerësimit dhe pavarësisht veprimeve të tjera pjesë përbërëse e këtij procesi.
3. Shkolla e Magjistraturës kujdeset që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i depozitimit të kërkesës, të dërgojë pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë informacionin e kërkuar.

Neni 26

Intervista personale

1. Pas grumbullimit të të dhënave nga inspektori i ngarkuar, gjyqtari, nëpërmjet një akti të shkruar, ka të drejtën të kërkojë një intervistë personale me Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku diskutohen elemente të ndryshëm të vlerësimit të punës së këtij gjyqtari.
2. Gjyqtari paraqet kërkesën e tij me shkrim brenda 3 (tre) ditëve nga momenti i njoftimit të grumbullimit të të dhënave, në të cilën parashtron objektin dhe arsyet e intervistës.
3. Gjyqtari do të intervistohet brenda 5 (pesë) ditëve nga depozitimi i kërkesës, nga Kryeinspektori ose inspektori i ngarkuar, të cilët kryejnë edhe dokumentimin e kësaj interviste nëpërmjet një akti të shkruar, që i bashkëngjitet dosjes së vlerësimit.

Neni 27

Vlerësimi paraprak

1. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë përgatit dokumentacionin për vlerësimin e gjyqtarit.
2. Inspektori i ngarkuar kujdeset për saktësinë dhe plotshmërinë e të dhënave të mbërritura në Inspektorat dhe, kur është rasti, kërkon konfirmimin e saktësisë së tyre nga kryetari i gjykatës ose plotësimin e tyre sipas rastit nga kryetari i gjykatës apo gjyqtari.
3. Inspektori i ngarkuar, pasi grumbullon aktet dhe krijon dosjen e vlerësimit të gjyqtarit apo kryetarit të gjykatës, jo më tej se 30 (tridhjetë) ditë, harton raportin konstatues të vlerësimit.
4. Në raportin konstatues, përshkruhen: periudha e vlerësimit, të dhëna personale të gjyqtarit; dhoma apo seksioni ku ai ka ushtruar veprimtarinë gjatë periudhës së vlerësimit; masat disiplinore të marra ndaj tij gjatë asaj periudhe si edhe pasqyron në mënyrë të detajuar të dhënat e rezultuara nga verifikimet sipas nenit 23, pika 1 të sistemit. Në përfundim, inspektori bën propozimin për vlerësimin e gjyqtarit duke iu referuar secilit grup të kritereve të vlerësimit.
5. Inspektori i ngarkuar, raportin përfundimtar të vlerësimit dhe dosjen e vlerësimit të gjyqtarit apo kryetarit të gjykatës i depoziton menjëherë pranë Kryeinspektorit.

Neni 28

Projektakti i vlerësimit

1. Kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pasi të ketë shqyrtuar dosjen e vlerësimit të gjyqtarit apo kryetarit të gjykatës, si dhe dosjen personale të gjyqtarit që ndodhet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, jo më tej se 60 (gjashtëdhjetë) ditë, përgatit Projektaktin e vlerësimit, të arsyetuar.
2. Në Projektaktin e vlerësimit gjyqtari vlerësohet si më poshtë:
 - a. Shumë mirë
 - b. Mirë

- ç. Pranueshëm
- d. I paaftë

Neni 29

Mënyra e vlerësimit

Vlerësimi përfundimtar bazohet në kuadrin e përgjithshëm të punës së gjyqtarit duke marrë në konsideratë kapacitetin e tij/saj lidhur me tre grupet e kriterëve të vlerësimit (Kreu II, Seksionet I, II dhe III), subjekt i këtyre rregullave:

Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” mund të jepet vetëm nëse puna e gjyqtarit është ose “shumë e mirë” për të tre seksionet ose “shumë mirë” për seksionin e II dhe në njërin nga dy të tjerat dhe “mirë” për atë që mbetet.

Vlerësimi i përgjithshëm “i paaftë” është i detyrueshëm nëse puna e gjyqtarit është vlerësuar “e paaftë” në dy nga tre seksionet.

Vlerësimi i përgjithshëm “i paaftë” mund të jepet nëse puna e gjyqtarit është vlerësuar “e paaftë” në seksionin e II dhe jo më shumë se “pranueshëm” në dy seksionet e tjera.

Vlerësimi i gjyqtarit nuk mund të jetë më shumë se “pranueshëm” nëse gjyqtari është vlerësuar “i paaftë” në një nga seksionet.

Neni 30

E drejta e ankimit

Projektakti i vlerësimit, i përgatitur nga Kryeinspektori, mund të ankimohet nga gjyqtari në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, brenda 10 ditëve, nga dita e komunikimit të tij.

Neni 31

Shqyrtimi i ankimit

1. Në rast të një ankimi, Këshilli i Lartë i Drejtësisë shqyrton jo më vonë se 2 (dy) muaj dosjen e vlerësimit të gjyqtarit, që i vihet në dispozicion.
2. Këshilli dëgjon gjyqtarin, pas tij Kryeinspektorin, me të drejtën për t’u bërë pyetje dhe vendos për vlerësimin.

Neni 32

Akti i Vlerësimit

1. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, brenda 4 (katër) muajve nga përfundimi i vlerësimit prej Inspektoratit, shqyrton dosjen e vlerësimit të gjyqtarit apo kryetarit të gjykatës dhe Projektaktin e vlerësimit, duke vendosur përfundimisht për vlerësimin e tyre.
2. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, kur çmon se vlerësimi i gjyqtarit duhet të jetë në një shkallë më të ulët se vlerësimi i bërë nga Kryeinspektori në Projektaktin e vlerësimit, ngarkon një nga anëtarët e tij (të zgjedhur nga Konferenca Kombëtare Gjyqësore) të përpilojë një Projektakt të ri vlerësimi i cili i komunikohet gjyqtarit. Ky i fundit, ka të drejtë që brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni, të parashtrojë kundërshtimet e tij. Vlerësimi përfundimtar i gjyqtarit realizohet në një seancë plenare të

Këshillit ku gjyqtari ka të drejtë të paraqitet duke parashtruar objeksionet e tij dhe mund t'u përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të Këshillit.

3. Akti i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për Vlerësimin e gjyqtarit bëhet pjesë e dosjes personale të gjyqtarit, ndërsa dosja e vlerësimit ruhet në Drejtorinë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Kërkimit Shkencor, deri në vlerësimin pasardhës.
4. Akti i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për Vlerësimin e gjyqtarit duhet të jetë i arsyetuar. Nëse Këshilli, bie dakort me arsyetimin e bërë nga Kryeinspektori në Projektaktin e vlerësimit, është e mjaftueshme që të bëhet referencë në këtë arsyetim.

Neni 33 **Vlerësimi i përshpejtuar**

1. Vlerësimi me procedurë të përshpejtuar i parashikuar në nenin 43, paragrafi 2 të Ligjit 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", do të realizohet sipas neneve 2 – 32 të këtij sistemi me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë nen.
2. Periudha e vlerësimit për procedurën e përshpejtuar është viti i fundit, i plotë kalendarik si edhe vendimet e cenuara të tij nga gjykatat më të larta, gjatë periudhës së fundit të vlerësimit në proces. Lista e gjyqtarëve që do vlerësohet sipas kësaj procedure miratohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
3. Afati i plotësimit të tabelave statistikore, dokumentimit të vendimeve të cenuara nga gjykatat më të larta dhe vlerësimit të gjyqtarit nga kryetari i gjykatës është 30 (tridhjetë) ditë nga njoftimi i fillimit të procedurës së vlerësimit.
4. Numri i çështjeve që do të përzgjidhen me short nga inspektorati është 4; numri i vendimeve që mund të prezantohen nga vetë gjyqtari është 3 ndërsa për çështjet e gjykuara tej afatit standard, i nënshtrohen shortit vetëm 5 % e tyre (sipas nenit 24, paragrafi 1, shkronjat "a", "b" dhe "ç" të sistemit).
5. Afati i plotësimit të dosjes së vlerësimit dhe përgatitjes së Projektaktit të vlerësimit nga Kryeinspektori është 30 (tridhjetë) ditë.
6. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, vendos për vlerësimin e gjyqtarëve jo më vonë se dy muaj nga koha e depozitimit të Projektaktit të vlerësimit nga Kryeinspektori.

Neni 34 **Dispozitë kalimtare**

- 1 Vlerësimi i gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apeleve për vitet 2005-2006, do të realizohet në bazë të dispozitave të parashikuara në Vendimin Nr.193/2, datë 11.05.2006, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me shtesat e ndryshimet përkatëse.
2. Gjyqtarët që ruajnë këtë status, megjithëse përkohësisht shërbejnë në institucione të tjera, do të vlerësohen për aftësitë e tyre profesionale për veprimtarinë gjyqësore të realizuar, pasi të rikthehen në ushtrimin e detyrës së gjyqtarit.

Neni 35
Dispozitë e fundit

1. Ky Sistem i Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, hyn në fuqi menjëherë.
2. Sistemi i Vlerësimit të Aftësive Profesionale të Gjyqtarëve, i miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë Nr.193/2 më datë 11.05.2006, shtuar e ndryshuar me vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Nr.207/2, datë 07.02.2007 dhe Nr.238/1/c, datë 24.12.2008, dhe Vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pjesë përbërëse e tij, Nr.199/3 datë 15.09.2006, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, shfuqizohen.

KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË

Miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Nr. 261/2, datë 14.04.2010.